



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2024:083627  
Datë: 07.11.2024  
Numri i dokumentit: 06417578

PPP.nr.29/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Mirvet Thaqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.M. “C” sh.a, me seli në Gjakovë, kundër debitorit I. I., nga Gjakova, Rr. “. . . , p.nr., për pagesën e borxhit sipas dokumentit të besueshëm, i lejuar sipas Urdhrit për përmbarim të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, P.nr.26/20 të datës 31.01.2020, jashtë seancës gjyqësore, me datë 07.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e identifikuar me numër të dosjes PPP.nr.29/24, e datës 14.03.2024, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.M. “C” sh.a, me seli në Gjakovë, kundër debitorit I. I., nga Gjakova, Rr. “. . . , p.nr.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të Kreditorit K.R.M. “C” sh.a, me seli në Gjakovë, ka lëshuar Urdhrin P.nr.26/20 të datës 31.01.2020, ndaj debitorit Y. I nga Gjakova, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit autentik - ekstraktit nga librat e kontabilitetit për shërbimet publike – heqjen e mbeturinave për nevoja shtëpiake për periudhën kohore nga data 31.01.2006 e deri me 31.12.2019, në shumën prej 791.35 euro, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore me kamatë ligjore prej 8%.

Kundër urdhrorit për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësimi në emër të debitorit I. I., ku theksohet se H.A.tashmë e disa vite është shfrytëzues i banesës e cila ndodhet në rrugën “. . . , dhe se ky i fundit ka marr përsipër edhe obligimet për pagesën e shpenzimeve për heqjen e mbeturinave. Ka shtuar se tani debitori Y. I. ka vdekur, me ç’rast prapësimin ia ka bashkëngjitur edhe certifikatën e vdekjes së tani të ndjerit dhe kopjen e tij të letërnjoftimit. Tutje ka theksuar se deklarata e dt. 21.01.2020 dhe kartela historike e konsumatorëve nuk paraqesin dokument të besueshëm për lejimin e përmbarimit si dhe duke paraqitur kundërshtim edhe për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Kreditori në afatin e paraparë ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Me datën 10.10.2024 gjykata në këtë çështje juridike përmbarimore kishte nxjerrë konkluzion, duke e urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej tre (3) ditëve nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, t’ia dorëzoj kësaj gjykate emrin, mbiemrin, emrin e prindit dhe numrin personal të personit ndaj të cilit ishte lejuar urdhri përmbarimor P.nr.26/20 i datës 30.01.2020 i lejuar nga Përmbaruesi privat Gjokë Radi. Kjo pasi që në emër të debitorit, prapësimin ndaj urdhrorit përmbarimor të lartcekur e kishte paraqitur një person tjetër, i cili theksonte se personi në fjalë (Y. I.) ka vdekur, duke prezantuar si dëshmi edhe certifikatën e vdekjes. Gjykata ka gjetur se tek urdhri mbi lejimin e përmbarimit figuron në cilësi të debitorit I. I., derisa në prapësimin e ushtruar dhe certifikatën e vdekjes të dorëzuar evidentohet personi Y. I., andaj edhe me qëllim të sigurimit të kushteve për procedimin e mëtutjeshëm të kësaj lënde përmbarimore, përkatësisht verifikimit nëse bëhet fjalë për të njëjtin person, edhe nxori konkluzionin e cekur si më lartë.

Me datën 06.11.2024 pranë kësaj gjykate kreditori K.R.M. “C” sh.a, me seli në Gjakovë ka dorëzuar një parashtrësë për tërheqjen nga propozimi përmbarimor në lëndën përmbarimore të evidentuar tek përmbaruesi privat me numër të lëndës P.nr.26/20. Në parashtrësë kreditori ka theksuar se *“tërheqja e kësaj lënde bëhet për shkak se nga gjykata kemi pranuar një Konkluzion, e cila urdhëron kreditorin që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, t’ia dorëzoj kësaj gjykate emrin, mbiemrin, emrin e prindit dhe numrin personal të personit ndaj të cilit është lejuar përmbarimi me Urdhrin përmbarimor të cekur më lartë. Kjo pasi gjykata ka gjetur se tek urdhri mbi lejimin e përmbarimit figuron debitori Y. I., derisa në prapësimin e ushtruar dhe certifikatën e vdekjes të dorëzuar evidentohet personi Y. I.”*

Tutje, në parashtrësën për tërheqje nga propozimi përmbarimor, kreditori ka shtuar se pas pranimit të këtij konkluzioni nga ana e gjykatës, kanë shqyrtuar të njëjtin dhe nuk kanë mundur

që të sigurojnë të dhënat e kërkuara për debitorin në fjalë. Andaj, në mungesë të plotësimit të të dhënave të debitorit, të kërkuara sipas urdhrit të gjykatës, kreditori ka njoftuar se bën tërheqjen e propozimit përmbarimor.

Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në vazhdim LPP) përkatësisht në nenin 42 paragrafin 1 shprehimisht parashihet se: *“Propozimi për përmbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore pa pëlqimin e debitorit”* dhe paragrafin 2. *“Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”*. Andaj, duke vepruar konform dispozitës së sipërcituar dhe pas vlerësimit të parashtrësës së dorëzuar, gjykata konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që të përfundohet procedura përmbarimore, pranë kësaj Gjykate.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 42 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.29/24, me datë 07.11.2024

Gjyqtari

Mirvet Thaqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.